



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE LIGJORE DHE PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ prot.

Vorë, më ____ . ____ . 2024

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[21.03.2024]

Drejtuar: **“Power Industries” shpk** me adrese: TiraneVore PICAR Tiranë, Vorë, Picar, Zona Kadastrale Nr.3974, Volumi 5, Faqe 143, Sipërfaqe Totale 2610 m2.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e hapur e Thjeshtur”,

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-91910-12-21-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [“Blerje materiale inerte (cakull, gure, stabilizant)”]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- “Construction Albania” shpk me Nipt L42208007G me vlerë të ofertës 1 041 250 (Një milion e dyzet e nje mije e dyqind e pesedhjete) lekë pa tvsh.
- 2- “Vellezerit Kuka” shpk me Nipt J63423440Q me vlerë të ofertës 1 083 330 (Një milion e tetedhjete e tre mije e treqind e tridhjete) lekë pa tvsh.
- 3- “Sark” shpk me Nipt K52531415H me vlerë të ofertës 1 094 000 (Një milion e nentedhjete e kater mije) lekë pa tvsh.
- 4- “Doksani-G” shpk me Nipt L21809501H me vlerë të ofertës 1 149 500 (Nje milion e njeqind e dyzet e nentemije e peseqind) lekë pa tvsh.
- 5- “Power Industries” shpk me Nipt L51706022H me vlerë të ofertës 1 218 850 (Nje milion e dyqind e tetembedhjete mije e teteqind e pesedhjete) lekë pa tvsh.
- 6- “Kegli-Duri” shpk me Nipt K94016202U me vlerë të ofertës 1 221 750 (Një milion e dyqind e njezet e nje mije e shtateqind e pesedhjete leke) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1- “Construction Albania” shpk me Nipt L42208007G

Konkretisht:

Operatori ekonomik nuk ka mundur te paraqese dokumentat provues te deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, per ortakun dhe administratorin, kjo parashikuar sipas Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 2, c) “personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;”

2- “Vellezerit Kuka” shpk me Nipt J63423440Q

Konkretisht:

Operatori ekonomik nuk ka mundur te paraqese dokumentat provues te deklaruar sipas afateve ligjore prane Autoritetit kontraktor bazuar ne kerkesen e nisur ne SPE me lende “Kërkesë për dorëzim dokumentacioni”, kjo parashikuar ne Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

3- “Sark” shpk me Nipt K52531415H

Konkretisht:

Bazuar ne Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik nuk ka mundur te paraqese ne dorezimin e dokumentacionit deshmin e penalitetit per ortakun dhe administratoret sipas parashikimeve ligjore, Dokumentat e paraqitura jane jashte afateve te vlefshmerise.

4- “Doksani-G” shpk me Nipt L21809501H

Konkretisht:

Referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit datë 10.01.2024, detyrimet e energjisë elektrike për muajin Nentor 2023 jane te maturuara në kuptim të përcaktimeve ligjore, afati i fundit për shlyerjen e tyre ka qenë data 31.12.2023.

Nese i referohemi vertetimit te OSHEE – 2023-9815709-LY date 22.11.2023 rezulton se muaji Nentor 2023 eshte i pa likujduar. Sipas ketij vertetimi debie rezulton se operatori eekonomik Doksani - G SHPK rezulton te kete ne total 0 (zero) leke detyrime per faturat e energjise elektrike deri ne daten 22.11.2023, pa perfshire faturen koherente te muajit Nentor 2023. Data e zhvillimit te procedures se prokurimit eshte 10.01.2024 dhe ne kete menyre sipas percaktimit ligjor shlyerja e detyrimeve te energjise elektrike per muajin Nentor e cila mund te behej deri ne daten 31.12.2023, detyrime keto (te muajit nentor) te cilat jane te maturuara.

Në këtë kuptim referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit (10.01.2024), KVO gjykon se, nuk ka plotësuar kriterin e veçante të kualifikimit lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në përputhje me përcaktimet në dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi.

Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) Operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve

jofamiliarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar”

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**“Power Industries” shpk** me adrese: TiraneVore PICAR Tiranë, Vorë, Picar, Zona Kadastrale Nr.3974, Volumi 5, Faqe 143,SipërfaqeTotale 2610 m2], se oferta e paraqitur me vlerë totale 1 218 850 (Nje milion e dyqind e tetembedhjetë mijë e teteqind e pesedhjetë) leke pa tvsh/totali i pikëve të marra [____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [**Bashkise Vore, Rruga “Unaza” Nr. 2**] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, **brenda 5 ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)

Vendim i KPP nr.414/7,

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

KRYETAR

BLERIM SHERA